

**Diplomaci në kushtet e Luftës së Ftohtë.
Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore e Miqësore
me Botën e Jashtme dhe propaganda**

Diplomacy in the Cold War era. The Albanian Committee for Cultural and Friendly Relations with Foreign Countries and Propaganda

Abstract: *The totalitarian regime set up an intricate system for propaganda, serving both the home department and the foreign department. The aim was to have a strong impact on people's mind to believe the regime's propaganda. Nurtured by the communist regime, propaganda covering the foreign countries formed part of the Albanian foreign policy during the Cold War. A special body was created for that purpose. It was the Albanian Committee for Cultural and Friendly Relations with Foreign Countries. Founded in 1950 according to the Soviet model, it worked intensively up to 1991, when political pluralism was introduced in the country. This body developed over the years, always trying to be useful to the foreign policy of communist state. It had state and social functions, as it enjoyed the right to create and support the so-called "friendship associations" of foreigners with Albania, through the Albanian embassies. Coordinated by this committee, these associations very often acted as distributors of Albanian propaganda abroad. Such propaganda created in the Albanians and not only, the impressions that their country, though isolated, had many friends all over the world.*

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, sot Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (më tej-MEPJ), u krijua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.89, dt.21.03.1964 "Mbi krijimin e arkivave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme". Sipas pikës 3 të tij "Arkivat që krijohen sipas këtij vendimi administrojnë të gjitha materialet dokumentare të sistemit të organeve të tyre". Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej -MPJ) si "arkiv sistemi MPJ-përfaqësi" që nga kjo kohë ruajti dhe menaxhoi vetë të gjitha pasuritë e veta arkivore, ato të trashiguara që nga viti 1944, dhe ato të krijuara rishtas, pa detyrimin për ti dorëzuar ato në Arkivin e Shtetit. Këtë status ky arkiv e ruajti edhe në ligjin nr.7726, dt.29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", ashtu edhe në ligjin nr.9154, dt.6.11.2003 "Për Arkivat".

Me qëllimin për të krijuar një fond unik arkivor të diplomacisë shqiptare, MPJ arriti një marrëveshje ndërinstytucionale me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, me 8.09.1999, për kalimin në pronësi të Arkivit të MPJ-së të dokumenteve të fondit historik të MPJ-së, ato të krijuara nga shërbimi i jashtëm shqiptar gjatë periudhës 1912-1944, të njohur nga studiuesit si “Fondi 151” e që ndodheshin pranë Arkivit të Shtetit. Po me këtë marrëveshje u tërhoqën edhe kopjet e dokumenteve për politikën e jashtme të fondit të ish-Komitetit Qendror të PPSH-së.

Kjo krijoi lehtësira më të mëdha për studiuesit e interesuar në historinë e diplomacisë shqiptare të cilët gjejnë në Arkivin e MPJ, çdo gjë që ka krijuar institucioni i MPJ që nga krijimi i tij në v.1912 e deri në vitet ‘2000. Nga ana tjetër gjithë kjo pasuri dokumentare e lokalizuar dhe e organizuar në një fond të vetëm arkivor pranë MPJ (sot MEPJ) është lehtësisht më e shfrytëzueshme për ti shërbyer më mirë nevojave të politikës së jashtme shqiptare për të permbushur misionin e saj në mbrojtje të interesave kombëtare.

Ky fond arkivor është i ndarë në dy nënfonde të tjera. Nënfondi 1 përmban afro 82 000 dosje të vlerësuara si “dokumente me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK)” me vlerë ruajtjeje të përhershme, dhe Nënfondi 2 përmban rreth 35000 dosje me ruajtje të përkohshme. Në nr.fletësh fondi arkivor i diplomacisë përmban rreth 6 milion dokumente. Ky fond pasurohet çdo vit me prurje të reja dokumentare nga drejtoritë e tjera në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme është depozituesi i parë i të gjitha marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që ka nënshkruar dhe nënshkruan shteti shqiptar. Në këtë kuadër ai ruan dhe shfrytëzon fondin e marrëveshjeve, traktateve dhe konventave që shteti shqiptar ka nënshkruar apo ka aderuar që nga viti 1920 e në vazhdim. Fondi i marrëveshjeve përmban 3500 marrëveshje dypalëshe (1920-2016) dhe 400 marrëveshje shumëpalëshe të të njëjtit hark kohor.

Përveç këtyre fondeve të mëdha, pranë Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme ndodhen edhe disa nënfonde të tjera më të vogla të cilat përfaqësojnë ngjarje të caktuara madhore të politikës së jashtme shqiptare, ose pjesë strukturore të kësaj Ministrie, por tashmë me aktivitet të mbyllur. Të tillë janë fondi studimor i Institutit të Studimit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Fondi UNSCOB (United Nations Special Committee on the Balkans) për Shqipërinë, fondi UNRRA (United Nations Relief and Rehabilitation Administration) për Shqipërinë, si dhe fondi dokumentar i Komitetit të Marrëdhënieve Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme (KMKMBJ).

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme pasurohet edhe nga bashkëpunimi i tij me arkivat homologe jashtë vendit. Me disa prej tyre e ka institucionalizuar këtë bashkëpunim duke nënshkruar edhe marrëveshje dypalëshe. Që nga viti 2014, Arkivi Historik i MEPJ është pranuar në Internatioanl Council of Archives (ICA) me qendër në Paris dhe është anëtare aktive e tij.

Për tu ofruar një shërbim sa më të vlefshëm studiuesve dhe politikës së jashtme të shtetit, me moton “arkiva të hapura, shoqëri e hapur, qeverisje e mirë”, që nga viti 2002 në Arkivin e MEPJ ka filluar dhe vazhdon pa ndërprerje procesi i deklasifikimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” i trashiguar nga periudha 1944-1992. Ky proces ka përfunduar për vitet 1944-1986 dhe vazhdon puna për deklasifikimin e dokumentacionit të v.1987. Informacioni i trashiguar me klasifikimin “sekret shtetëror” i nënshtrohet kritereve të ligjit nr.8457, dt.11.2.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar, dhe deklasifikohet apo vazhdon të ruaj nivelin e tij të klasifikimit sipas kërkesave të këtij ligji.

Një ndër këto fonde arkivore që hapet për herë të parë për publikun është edhe fondi dokumentar i krijuar nga Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme (më tej KMKMBJ), një makine e propagandës me jashtë të shtetit komunist shqiptar nga viti 1950 deri në v.1991.

Totalitarizmi si fenomen historik ka tipare të papërcaktuara qartë. Studiues të ndryshëm në dy anët e Atlantikut janë pajtuar me konkluzionin e arritur nga i ndjeri Raymond Aron, filozof-politolog, i cili në vitin 1965 arriti të përcaktonte 5 elementë kryesore të këtij fenomeni historik. Ndër to veçojmë: *Ideologjia e partisë që ka monopolin e pushtetit bëhet e vërteta zyrtare e shtetit. Për përhapjen e kësaj të vërtete zyrtare, shteti merr përsipër nga ana e tij një monopol të dyfishtë, monopolin e mjeteve të forcës, si dhe atë të lavazhit të truve. Tërësia e mjeteve të masmedias: radioja, televizioni, shtypi drejtohen dhe komandohen nga shteti dhe nga ata që e përfaqësojnë.*¹

Në Shqipëri, vendi i vogël totalitar komunist, gjate kohës së Luftës së Ftohtë 1945- 1990, kur në emër të luftës ideologjike përplaseshin interesat e dy botëve me sisteme të ndryshme ekonomike e politike, lavazhi i trurit, ndryshe propaganda e rregjimit komunist do të shtrihej edhe jashtë kufijve të vendit, tek shqiptarët me banim jashtë, elementët marksistë, dhe simpatizantë të Shqipërisë e shqiptarëve. Makina e propogandës jashtë vendit mbështetej mbi rezultatet e punës propogandistike brenda vendit dhe pasqyronte të amplifikuara rezultaet e saj.

Në prill 1959, Misto Treska ,drejtues i asaj kohe i Komitetit të Marrëdhënieve Kulturore me Botën e Jashtme (më tej-KMKBJ), duke folur

1 R. Aron, *Democratie et totalitarisme*, Paris 1987, f.287-288.

për detyrat e propagandës shprehej “ *Me fjalën propagandë ne kuptojmë punën që duhet të bëjmë me forma dhe mjete të ndryshme për të paraqitur në mënyrë të drejtë një realitet që ekziston dhe ti bindim njerëzit për këtë realitet. Duke u nisur nga kjo propaganda e jonë duhet të jetë bindëse, konkrete, e shpejtë dhe luftarake. Shkurt duhet të përshkohet nga një nivel i lartë ideologjik dhe politik dhe të bëhet me forma të atilla që të prekë drejtpërdrejt dhe sa më thellë masat të cilave u drejtohem, sepse në llogari të fundit janë masat ato që do të mbajnë qëndrim dhe do të veprojnë pozitivisht apo negativisht ndaj një çështjeje të caktuar.*² Lloji i propagandës, qëllimet e format e saj, grupet të cilave u drejtohej, ndiqin zhvillimet në politikat e brendëshme e të jashtme të rregjimit komunist. Ajo prodhohej prej rregjimit dhe i shërbente rregjimit.

Pas prishjes së bujshme të marrëdhënieve me Jugosllavinë në vitin 1948, për të mbështetur pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, veçanarisht brenda bllokut komunist, e për të luajtur si duhet rolin e anëtarit të bllokut komunist në përballjen e tij me bllokun tjetër perendimor, Sekretariati i ish-KQ të PPSH me 20 janar 1949 miratoi një vendim mbi propagandën e jashtme. Ky vendim përcaktoi të ashtëquajturën “Platforma për popullarizimin e vendit tonë.” E gjithë puna do të përqëndrohej tek miqësia me BRSS si një mbështetje e madhe politike dhe ekonomike e shtetit komunist shqiptar, dhe tek vendet e demokracive popullore, duke veçuar Bullgarinë si shtet që ndodhej në perimetrin strategjik të rrethimit nga “armiqtë e jashtëm”, me argumentin se ndodhej në kufi me Greqinë, që ishte “bërë pro-amerikane”; dhe Jugosllavinë “armiqtë e brendshëm” pas tensionimit e prishjes së marrëdhënieve ndërmjet dy partive komuniste.”

“*Popullarizimi i vendit*” i do të bëhej me këto drejtime kryesore:

Në radhë të parë, duhej të popullarizoheshin ngjarjet kryesore të aktualitetit shqiptar pas luftës; të popullarizohej lufta nacional-çlirimtare e popullit; të popullarizohej roli udhëheqës, organizues dhe drejtues i Partisë së Punës së Shqipërisë dhe ndihma e gjithëanshme e BRSS dhe Partisë Bolshvike; të vihej në evidencë veprimtaria armiqësore e amerikanëve dhe elementëve reaksionarë në shërbim të tyre. “Popullarizimi” i këtyre aspekteve synonte kthimin e tyre në mite. Në radhë të dytë të propagandës do të ishin kultura dhe historia e popullit shqiptar. Mbi këtë platformë, Drejtoria e Agjitacion-Propagandës e ish-KQ të PPSH ngarkohej të përgatiste udhëzimet bazë që do të shërbenim si orientim për organet e ndryshme kulturore dhe institucionet qeverisëse në hartimin e planeve të tyre të punës, si Instituti i Studimeve Shkencore, Komiteti i Arteve dhe i Kulturës, Lidhja e Shkrimtareve, Seksioni i Shtypit të Ministrisë së Punëve

2 Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më tej-AMEPJ), Fondi KMKMBJ, Viti 1959, D.2/Udhëheqja.

të Jashtme.³ Tre muaj më pas, me 22 prill 1949, KQ i PPSH mori vendim edhe për orientimin e përmbajtjes së shtypit dhe drejtimet e shpërndarjes së tij.⁴

Në punë e sipër ndjehej nevoja e një dore të fortë koordinuese e organizuese për të gjithë aktivitetin praktik të propagandës me jashtë, që ajo të bëhej një veprimtari e zakonshme organike e politikës së jashtme shqiptare. Në vitin 1950, me Vendim të ish-KQ të PPSH, u krijua Komiteti shqiptar për Marrëdhëniet Kulturore me Botën e Jashtme, dhe Kahraman Ylli, diplomat, ishte kryetari i parë i tij. Kjo strukturë përcaktohej si “organ drejtues dhe koordinues për propagandën dhe marrëdhëniet kulturore me botën e jashtme”⁵

Kjo strukturë e re në fillim ishte pa detyra dhe kompetenca të përcaktuara qartë, por me objektivin “për tu bërë një faktor i rëndësishëm në organizimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve kulturore të Shqipërisë me botën e jashtme dhe në radhë të parë me vendet socialiste”.⁶ Forma do të ishte e njëjtë brenda bllokut komunist të lindjes, ai do të ndiqte modelin sovjetik. Krijimin e këtij Komiteti e përshëndetën institucionet homologe nga vendet e demokracive popullore që ishin krijuar më parë. Në korrik të v.1949 ishte krijuar Instituti i Marrëdhënieve Kulturore në Hungari sipas modelit të Komiteti Shtetëror të Marrëdhënieve Kulturore midis BRSS dhe Botës së Jashtme, Instituti rumun për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme, etj. Ky i fundit kishte si qëllim të veprimtarisë së tij edhe studimin dhe përhapjen në vend të kulturës progresiste të huaj, pasi kalonte në filtrën e qeverisë komuniste, përveçse të bënte të njohura jashtë vendit realizimet kulturore të Rumanisë.⁷ Përhapja në vend e kulturës së huaj progresiste nuk ishte pjesë e platformës së punës të Komitetit shqiptar për Marrëdhëniet Kulturore me Botën e Jashtme, dukuri që justifikohet qartë me modelin e komunizmit konservator që po aplikohet në Shqipëri dhe e atyre viteve.

Në vitin 1952, me vendim të Byrosë Politike u vendos që Dega e Shtypit pranë MPJ të botonte një herë në muaj revistën “Shqipëria e Re” dhe ta shpërndante atë jashtë vendit. Kjo revistë politiko-shoqërore në fillimet e saj nuk kishte redaksi, por konsiderohej material pune politike e si e tillë hartohej nga specialistët e Degës së Shtypit në MPJ. Për të përforcuar propagandën jashtë vendit, u vendos që të shpërndareshin tre fletushka

3 AMEPJ, V.1949, D1, f.1-3, *Vendim i KQ të PPSH për Propagandën e jashtme*. 20.1.1949.

4 AMEPJ, 1949, D.1, fl.4-6, 22.4.1949, *Korrespondencë e KQ të PPSH me MPJ*.

5 AMEPJ, V.1961, D.13, fl.1, *Raport për punën e KMKBJ për vitin 1961*.

6 AMEPJ, Fondi i KMKMBJ, Viti 1959, D.2/Udhëheqja. “Relacion për punën e Komitetit të Marrëdhënieve Kulturore me Botën e Jashtme”.

7 AMEPJ, Fondi i KMKBJ, Udhëheqja 1950, *Telegrame të ardhura me rastin e krijimit të KMKBJ, nentor 1950*

e panflete shtesë në muaj bashkë me shtypin.⁸ MPJ ishte e ngarkuar dhe përgjegjëse që në bashkëpunim me Drejtorinë e Agjitacion Propogandës në ish-KQ të PPSH të dërgonte e të shpërndante jashtë vendit të gjitha materialet propagandistike që prodhonte KMKBJ.⁹

Në v.1958, për një funksionim më praktik të KMKBJ nga një strukturë politike e pavarur, por e orientuar dhe e kontrolluar nga Drejtoria e Agjitacion-Propogandës në ish-KQ të PPSH, kaloi në varësinë e një institucioni shtetëror siç ishte Ministria e Arsimit dhe Kulturës, duke u bërë pjesë e strukturës administrative të shtetit.¹⁰ *Propaganda me botën e jashtme*-deklaracionin drejtuesit e kësaj strukture propagandistike - *duhet të konsiderohet si një mjet me shumë rëndësi për forcimin e miqësisë me popujt e tjerë të kampit socialist, për afrimin e popujve të vendeve jo-socialiste me popullin shqiptar, për popullarizimin e sukseseve të Republikës së Shqipërisë, për përhapjen e ideve socialiste në botë e forcimin në këtë mënyrë të paqes.*¹¹

Në 28 prill 1958 u krijua Shoqata e parë e Miqësisë, ajo midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë.¹² Ajo kishte dy qendra në Moskë dhe Tiranë dhe u krijua nën diktatin dhe modelin sovjetik. Të gjithë anëtarët e saj duhet të ishin anëtarë të PPSH, shumica e tyre nga radhët e luftës. Me prishjen e marrëdhënieve me BRSS në dhjetor të v.1961 u ndërpre edhe aktiviteti i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-BRSS, si një shoqatë me karakter shtetëror që mbështeste “vullnetarisht” marrëdhëniet dypalëshe, duke lënë pas një material voluminoz propagandistik akoma të padërguar në destinacion, jo vetëm për pasqyrimin e realitetit shqiptar në BRSS, por edhe për imponimin e modelit sovjetik në aspekte të ndryshme të jetës dhe realitetit shqiptar. Kjo do të jetë e vetmja shoqatë me këtë mision. Shoqatat e tjera të miqësisë që do të krijohen më vonë kanë karakter të njëanshëm, ata krijohen jashtë vendit dhe luajnë rolin e distributorit të propagandës komuniste shqiptare në shtresa të ndryshme shoqerore të vendeve të tyre.

Në fund të viteve '50-të, Komiteti filloi të zgjeronte aktivitetin e tij në drejtim të vendeve arabe, kryesisht ato vende që kishin rënë nën ndikimin sovjetik. U krijua shoqata e miqësisë Shqipëri-vende arabe dhe filloi puna për hartimin e marrëveshjes kulturore me Republikën Arabe të Bashkuar (Egjypt e Siri) me presidentin egjiptian socialist Nasser në krye. Kështu në Shqipëri në v.1959 ekzistonte dy shoqata miqësisë, ajo me BRSS dhe me

8 AMEPJ, V.1952, D.2, fl.18, *Korrespondencë e MPJ me Ministrinë e Financave për miratim shpenzimi*, 25.3.1952.

9 AMEPJ, V.1053, D.332, fl.7, *Korrespondencë e MPJ me Ministrinë e Financave*, dt.3.3.1954.

10 AMEPJ, Viti1958, D.60, fl.15, *Korrespondencë midis ambasadës shqiptare në Moskë dhe MPJ*, 14.4.1958.

11 Po aty

12 AMEPJ, V.1958, D.60, fl.20, *Korrespondencë e ambasadës shqiptare në Moskë me MPJ*, 20.5.1958.

vendet arabe.¹³

Meqenëse në puneën e Komitetit po demonstrohej karakteri teknikent i tij si makinë prodhuese e propagandës, por me mungesa në njohjen e nivelit të marrëdhënieve të shtetit shqiptar me shtetet e tjera, ku bënin pjesë edhe marrëdhëniet kulturore dhe propaganda me jashtë e shtetit, Sekretariati i KQ të PPSH me vendimin e tij nr.123, dt.31.3.1959, duke ndjekur modelin sovjetik, vendosi ti rekomandonte KM që KMKBj të kishte lidhje shtetërore me MPJ dhe lidhje partie me Drejtorinë e Jashtme pranë ish-KQ të PPSH. Kryetari i tij duhej të ishte patjeter anëtar i Kolegjiumit të MPJ. Sipas propozimit, ai mund të varej edhe nga Keshilli i Ministrave, por përsëri duhej të ishte anëtar i Kolegjiumit të MPJ dhe jo i Kolegjiumit të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës. Nga ana tjetër u propozua që Komiteti të mos ishte vetëm zbatues praktik i planeve të punës kulturore që sillnin institucionet e tjera, por të ishte vetë hartues e koordinues i tyre në bazë të orientimeve të marra nga PPSH dhe organet përkatëse eprorë të shtetit.

Komiteti ngarkohej gjithashtu që të merrej edhe me politikën e shpërndarjes së materialeve propagandistike mbi bazën e orientimeve të dhëna nga KQ e PPSH dhe sipas parimit të diferencimit të propagandës sipas nevojave, vendeve dhe shtresave që u destinohej ajo. Shumë i rëndësishëm ishte fakti që veç funksioneve shtetërore, Komiteti ngarkohej të kryente edhe funksione shoqërore duke hyrë në kontakte me shoqata, individe e personalitete me peshë jashtë vendit.¹⁴

Këshilli i Ministrave me marrjen e propozimit nga ish-KQ i PPSH, kërkoi një relacion pune nga KMKBj për problemet që ishin ndeshur që nga krijimi i tij dhe që pengonin realizimin e objektivave të vëna. Në këtë relacion të përgatitur nga Misto Treska, drejtues i KMKBj të asaj kohe, pasqyrohen edhe propozimet për një përmirësim pune të kësaj strukture sipas nevojave që kishte paraqitur koha. Vlen të theksohen dy prej tyre:

Së pari, nga interesi në rritje për të njohur Shqipërinë, me nxitjen e përfaqësive diplomatike shqiptare aty ku ato ndodheshin dhe me mbështetjen e Komitetit, gjatë viteve '50-të, ishin krijuar edhe disa grupime të vogla simpatizantësh politikë e jo vetëm në Itali, Francë, Angli e Norvegji, që funksiononin si shoqata miqësie jo shtetërore me Shqipërinë. Përbërja e tyre ishte e ndryshme, simpatizantë të Shqipërisë, njerëz revolucionarë, marksistë-leninistë, por edhe njerëz me bindje të ndryshme ideologjike. Keshtu aspekt i veçantë i punës së KMKBj duhej të ishte propagandimi i Shqipërisë me ane të shoqatave të miqësisë në vendin tonë dhe atyre që ishin krijuar dhe funksiononin në vendet e huaja. Shoqatat e para të miqësisë të krijuara jashtë Shqipërisë mbështeteshin në aspektin organizativ dhe financiar nga shteti shqiptar. Në relacionin e përgatitur nga KMKBj në fund

13 AMEPJ, Fondi i KMKBj, Viti1959, D.2/*Analizë pune e Komitetit për vitin 1959.*

14 AMEPJ, Fondi i KMKBj, Viti1959, D.1/*Vendim i KQ të PPSH.*

të vitit 1959 thuhej “ Siç dihet shoqatat e miqësisë me Shqipërinë ndihmohen në forma të ndryshme nga Komiteti yne dhe nga përfaqësitë tona. Meqenëse kjo ndihmë shtetërore shkon për disa organizata joshtetërore krijohet një situatë e vështirë ligjore, dhe kjo çon deri në masa suprimimi të këtyre shoqatave nga ana e autoriteteve qeveritare të vendit ku funksiononin duke i akuzuar si organizata të lidhura me organet shtetërore shqiptare. Në këtë aspekt, propozohet që të shtohen përpjekiet për krijimin në Shqipëri të shoqatave të miqësisë me vendet respektive duke filluar hë për hë me Italinë dhe Francën, kjo sipas modelit të shoqatës Shqipëri-BRSS. Megjithatë duke qenë vende kapitaliste, shoqatat në Shqipëri nuk kanë çfarë ofrojnë e marrin me këto vende, e kështu rrezikohej të mbeteshin fiktive.”¹⁵

Së dyti, Drejtim tjetër i veprimtarisë së KMKBJ ishte edhe puna me kolonitë shqiptare nëpër botë, kryesisht emigracioni ekonomik, që kishin organizatat e tyre shoqërore e patriotike. Komiteti kishte vendosur marrëdhënie me këto organizata, por meqenëse Komiteti ishte organ shtetëror i vinte këto organizata në pozita të vështira. Me qëllim që të mos humbisnin lidhjet e këtyre kolonive me Shqipërinë, por përkundrazi të zgjeroheshin ato, në relacionin e KMKBJ propozohej të krijoheshin në Shqipëri një shoqatë patriotiko-shoqërore e të rikthyerve politike dhe ekonomike që do të krijonte lidhje dhe marrëdhënie me organizatat dhe elementet e mërgimit dhe të krijonte një fushë të gjërë propagandistike me kolonitë shqiptare të mërgimit. Aktivitetin praktik të kësaj organizate, si deri në atë kohë, do ta kryente Komiteti.¹⁶

Pas këtij relacioni të përpiluar nga Misto Treska, Kryetar i KMKBJ dhe Mihail Prifti, drejtor i Drejtorisë së Jashtme të ish-KQ të PPSH, Këshilli i Ministrave la detyrë që brenda vitit 1960 të përpilohej dhe të miratohej nga organet kompetente shtetërore “Rregullorja” mbi detyrat, kompetencat, dhe marrëdhëniet me organet shtetërore dhe institucionet e ndryshme të KMKBJ.” Pasi mori miratim nga Drejtoria e Jashtme e ish-KQ të PPSH dhe Sekretari përkatës i ish-KQ, në shtator 1960 u tërhoqën edhe mendimet e institucioneve zbatuese, siç ishte MPJ.¹⁷ Rregullorja “Mbi funksionet dhe detyrat e Komitetit Shqiptar për Marrëdhëniet Kulturore me Botën e Jashtme” u miratua me VKM nr.104, dt.6.4.1961.

Kjo Rregullore konsolidonte përfundimisht formën, strukturën dhe detyrat e Komitetit shqiptar për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme. Ai përcaktohej si një institucion shtetëror me llogari të pavarur, i ngarkuar edhe me funksione shoqërore. Pikërisht për të kryer këtë funksion shoqëror, ai duhej të mos ishte pjesë ekskluzive e një institucioni shtetëror si MPJ, por një njësi autonome e MPJ që do të varej e do të merrte udhëzime

15 AMEPJ, Fondi i KMKBJ, viti 1959, D.2/ Udheheqja.

16 AMEPJ, Fondi i KMKBJ, viti 1959, D.2/ Udheheqja.

17 AMEPJ, v.1960, D.3, fl.1, *Korrespondencë e KMKBJ me MPJ*, 23.09.1960

si nga MPJ ashtu edhe nga Drejtoria e Jashtme e ish-KQ të PPSH. Ky Komitet në varësi të udhëzimeve të marra do të interesohej për vendosjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve kulturore zyrtare shtetërore midis RPSH dhe vendeve të tjera dhe do të nënshkruante në emër të palës shqiptare marrëveshje kulturore dhe planet përkatëse.

Vendimi i qeverisë shqiptare i njihte të drejten KMKBJ *“të krijonte dhe të zhvillonte lidhje në fushën shoqërore me institucione, organizata të ndryshme dhe individë, siç ishin shoqëritë patriotike shqiptare, shoqatat e miqësisë me Shqipërinë etj që interesohen dhe punojnë për njohjen e Shqipërisë në vendet e tyre dhe për fuqizimin e miqësisë midis vendit tonë dhe vendeve ku ato veprojnë, me institucione dhe njerëz të huaj që tregojnë interes dhe punojnë për popullarizimin e RPSH në vendet e tyre”*.¹⁸

Komiteti ngarkohej të bënte vetë propagandë dhe të koordinonte propagandën me jashtë që bënin institucionet dhe organizatat e tjera të vendit. Për të realizuar misionin e tij ai kishte të drejtë të bashkëpunonte me institucionet e tjera shtetërore dhe organizatat shoqërore. Në organikën e tij, përveç stafit të përhershëm u krijua një Këshill Drejtues me 40 anëtarë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe shoqërore që merreshin me marrëdhëniet kulturore dhe me propagandën me botën e jashtme.

Sipas rregullores, pranë këtij Komiteti me urdhër të MPJ, mund të krijoheshin komisione të veçanta që do të kryenin funksionet e shoqatave të miqësisë me vendet e tjera. Përbërja dhe detyrat e këtyre komisioneve caktoheshin në urdhërin e krijimit të tyre. Kjo pikë nuk u zbatua deri vonë për shkak të izolimit politik e kulturor të shoqërisë shqiptare që erdhi duke u përforcuar pas vitit 1961 me prishjen se marrëdhënieve me BRSS e zbehjen e tyre me vendet e kampit socialist.

Komiteti do të mbante lidhje të drejtëpërdrejta me përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë për zbatimin e planeve kulturore të bashkëpunimit. Ato do të raportonin në Komitet në mënyrë periodike. Komiteti do të mbante lidhje edhe me përfaqësitë e huaja të akredituara në Shqipëri.¹⁹ Përfaqësitë diplomatike shqiptare do të shpërndanin materialet propagandistike e ideologjike, fjalime të udhëheqësve kryesorë të Partisë dhe shtetit, që vinin nga komiteti tek qytetarët e vendit ku ishin akredituar, sidomos tek grupet me tendencë marksiste-leniniste (më tej m-l), përfaqësitë e huaja atje, shqiptarët e kolonive shqiptare etj. Materiali kryesor propagandistik ishte revista “Shqipëria e re”. Përveç grupeve të mësipërme kjo revistë u dërgohej për lexim edhe bibliotekave dhe librarive jashtë vendit. Në vitin 1970 pranë Misionit tone në New York u dërguan rreth 400 kopje të revistës “Shqipëria e re”, specifikisht 300 kopje

18 Arkivi Qendror i Shtetit (më tej AQSH), F.490, Viti 1961, D.245, fl.15-20, *Vendim i Këshillit të Ministrave*

19 AQSH, F.490, Viti 1961, D.245, fl.15-20, *Vendim i Këshillit të Ministrave*.

në anglisht, 50 kopje në shqip, 14 kopje në arabisht, 10 kopje në frëngjisht e 5 kopje në rusisht. Kopjet do të shpërndareshin në SHBA dhe Kanada falas. Meqenëse ekonomikisht kjo kishte një kosto të konsiderueshme financiare, dhe nga ana tjetër ishte rritur interesi për të njohur Shqipërinë, qofte edhe nëpërmjet propagandës pasi ishte e vetmja mënyrë për të marrë informacion nga Shqipëria e izoluar, filloi të diskutohet edhe shitja e revistës, pavarësisht se kishte pengesa juridike në realizimin e kontratave të tilla.²⁰

Funksioni shoqëror që ju ngarkua Komitetit të Marrëdhënieve Kulturore me Botën e Jashtme, përveç atij shtetëror, u pasqyrua edhe në emërtesën e tij. Tani e prapa ai do të emërtohet Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme.

Pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike me ish BRSS, dhjetor 1961, pozita ndërkombëtare e Shqipërisë komuniste u vështirësua. Brenda bllokut komunist filloi një fushatë armiqësore ndaj saj dhe lidhjes së saj me Kinën Komuniste që kishte dalë nga blloku në 1961. Kjo detyroi qeverinë shqiptare që përveç propagandës për njohjen e sukseseve të shtetit komunist shqiptar tani të përballonte edhe propagandën e huaj të ashtëquajtur “armiqësore” ndaj Shqipërisë. Për këtë u përpunua një platformë e plotë kundërpropogande ndaj kësaj fushate. Edhe këtë detyrë do ta kryente Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme. Ai tashmë konsiderohej “organ i specializuar në fushën e propagandës dhe kunderpropagandës për jashtë”. Ky zhvillim i ri në politikën e jashtme shqiptare do të pasqyrohej edhe në qëndrimin ndaj shoqatave të miqësisë jashtë. Meqë krijoheshin mbi baza politike përcillnin të gjitha përplasjet politiko-ideologjike të PPSH me partitë e tjera komuniste, duke u përçarë në fraksione. Pas viteve 60-te shoqatat e miqësisë u riorganizuan, u krijuan të reja dhe u vendosën nën drejtimin e partive apo grupeve m-l. Shoqatat varionin nga shumë të vogla deri në numerikisht të mëdha me nga 500-1000 e më shumë anëtarë.

Për një nivel më profesional e diplomatik të propogandës me jashtë, në vendimin e Sekretariatit të ish-Komitetit Qendror të PPSH “Mbi propagandën me botën e jashtme” të qershorit 1972 u ngarkua Ministria e Punëve të Jashtme që nëpërmjet KMKMBJ të bënte koordinimin e propagandës me institucionet e ndryshme dhe organizatat shoqërore për botën e jashtme. Dukej se gjërat nuk po funksiononin si duhet, dhe në fushën e propagandës kishte paralelizma të paefektëshme. Ministri i Punëve të Jashtme propozoi amendime në rregulloren e funksionimit të KMKMBJ. Kjo rregullore e re u miratua me VKM nr.181, dt.10.06.1977

Tani KMKMBJ do të funksiononte përfundimisht si strukturë e MPJ, për

20 AEMPJ, Fondi i KMKMBJ, viti 1970, D.16/ Veprimtaria e Komitetit, *Relacion i Misionit tonë në New York për Komitetin*, 11.4.1970.

specifikën e punës së saj e të lidhjeve me përfaqësitë tona diplomatike, qe ti jepej mundësi të njihte e të përcaktonte më mirë “*nevojat e problemet që prokuponin publikun e jashtëm dhe veprimtarinë positive dhe negative të organeve të propagandës të vendeve të huaja ndaj Shqipërisë, përmbajtjen e propagandës së huaj ndaj vendit tone, si dhe efektin e propagandës shqiptare*”.²¹

Ndërkohë po konturohej përherë e më qartë marrëdhënia konfliktuale me partinë komuniste kineze, dhe hyrja e Shqipërise komuniste në rrugën e vetëizolimit politik dhe ekonomik. Kjo situatë e ndërlikuar ndërkombëtare për shtetin komunist shqiptar kërkonte edhe një punë më të specializuar propagandistike që të “mbante lart” emrin e Shqipërisë, pavarësisht se po pozicionohej kundër të gjithëve. Propaganda nuk do të ishte më një mall që shitej për nevoja të përgjithshme, por do të ndërtohej e bazuar mbi tiparet specifike të çështjeve dhe problemeve më të rëndësishme me karakter ideologjik, politik, ekonomik, kulturor e shoqëror që prokuponin lëvizjen punëtore dhe shtresa të ndryshme të popullsisë së vendeve të tjera, duke marrë rolin e liderit ideologjik, dhe modelit të paanshmërisë tek vendet e paangazhuara në blloqe. KMKMBJ duhej ti bënte analizë këtyre problemeve dhe ti propozonte për miratim udhëheqjes së PPSH dhe shtetit drejtimet e detyrat kryesore të propagandës dhe kundërpropagandës.

Pas një fushate të gjërë propagandistike jashtë vendit, ku çdo gjë i atribuohet rolit udhëheqës të PPSH e cila “njihte vetëm suksese”, kishte ardhur koha të mateshin frytet e saj e të përdorëshin ato për politikën e brendëshme duke përdorur mjetet e shtypit dhe radio-televizionit. Kjo do të ndihmonte në krijimin e bindjes brenda vendit se Shqipëria nuk ishte e izoluar, kishte miq ngado të cilët befasoheshin nga realiteti shqiptar dhe që shpreheshin me bindje se me pozicionin që kishte zgjedhur Shqipëria në skenën nderkombetare, po ecte në rrugën e suksesit.²² Për çdo mik të Shqipërisë filloi të plotësohej një kartelë ose një dosje, sipas rrethanave, dhe nga ana tjetër filloi hartimi i historikut të shoqatave të miqësisë sidomos me vendet perendimore, France, Suedi, Danimarkë, etj. Ndërkohë harta e shoqatave të miqësisë me Shqipërinë zgjerohej me ritme të shpejta, sidomos tek vendet e botës së tretë. Në vitet '70-të numëroheshin 30 shoqata, gjysma në Evropë e gjysma në Azi Afrike e kontinentin amerikan, mes tyre në RFGJ, Kanada, Japoni e SHBA.²³ Nga Shqipëria dërgoheshin libra e materiale edhe për krijimin e bibliotekave të shoqatave. Përveç propagandës në letër, trajtohej edhe propaganda me arikuj artizanale. Shoqatave i përcilleshin prodhime artizanati, filma dokumentare, filma

21 AMEPJ, , V.1977, D.6, fl.31, Rregullore e KMKMBJ.

22 AMEPJ, Viti 1977, D.6, fl2-7, *Relacion i Ministrisë të Punëve të Jashtme për riorganizimin e KMKMBJ, tetor 1976.*

23 AMEPJ, V.1981, D.13, *Relacion i KMKMBJ*, fl.69-70.

artistike, shirita me muzike popullore, ekspozita fotografike, gazeta Zëri i Popullit, pulla poste, distinktive me flamurin shqiptar, albume, etj.

Në rolin e koordinatorit të propagandës me jashtë, KMKMBJ përgjigjej zyrtarisht për saktësinë e të dhënave dhe përmbajtjen ideologjike e politike të të gjitha materialeve propagandistike që do tu dërgoheshin përfaqësive, shoqatave të miqësisë, kolonive shqiptare e miqve nga institucione të ndryshme kulturore e shkencore në vend. Si rrjedhojë, Komiteti kishte të drejtë e detyrë të sugjeronte e të ndërhynte në organet kompetente për të ndaluar dërgimin jashtë të materialeve që nuk ishin të sakta e të përshtatshme.²⁴

Pas tensionimit të marrëdhënieve me Kinën komuniste, të gjitha shoqatat në v.1979 iu nënshtruan një procesi spastrimi nga elementët maoiste. Pjesa që mbeti u solidarizua me Partinë dhe qeverinë shqiptare dhe dënuan qëndrimin e Kinës. Çdo vit KMKMBJ ftonte miq 70-80 veta e deri në 100 veta në vit. Pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën ky numër u rrit në 265 veta në vit duke fshehur imazhin e një vendi te veteizoluar siç ishte Shqipëria e gjysmës së parë të viteve '80-të. Për shkak të vështirësive ekonomike që kalonte vendi, vetëm vizitat e 15-20 miqve përballoheshin nga buxheti i shtetit, tjerët i kryenin vizitat me kostot e tyre.²⁵ Në këtë fazë të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, thelbi i propagandës ishte trumbetimi i parimit të *"mbështetjes në forcat tona"*, Plani 5-vjeçar që po miratohej në 1981, i mbështetur totalisht *"në forcat tone"* konsiderohej nga shoqatat e miqësisë si *"një epike trimërie e paparë në historinë e popujve të vegjël të botës"*.²⁶

Veteizolimi, ndërprerja e ndihmave nga jashtë, po sillnin pasoja të rënda ekonomike. Tani nevoja ekonomike po prevalonte para nevojës për mbështetje ideologjike. Këtë nevojë do ta përcillte edhe propaganda me jashtë. Mes objektivave dhe drejtimeve kryesore të propagandës me jashtë me rastin e 40-vjetorit të PPSH dhe Kongresit të saj të 8-të, u dha udhëzimi që: *"Akademia e Shkencave, Universiteti i Tiranës, KMK dhe institucione të tjera, kur kanë në plan të ftojnë personalitete të huaja, këta ti zgjedhin e ti ftojnë me emër në fushat e tyre e jo thjeshtë persona partiakë e ideologjikë, të vinin ata që me të vërtetë paraqesin interes për vendin tonë, qoftë në planin shkencor, qoftë në planin propagandistik. Duhej punuar në mënyrë të atillë që mundësisht, të gjithë turistët e huaj të mbeteshin dashamirës të Shqipërisë socialiste për ta ndihmuar atë në të ardhmen"*.²⁷ Shumë kujdes i duhej

24 Po aty, fl.30-36.

25 AMEPJ, V.1982, V.82/1, *Material i KMKMBJ 1979, fl.19,20*

26 AMEPJ, V.1982, D.22, fl.12-20, *Material për Kolegjiumin e MPJ, Mbi pritjen e miqve dhe dashamirësve në Shqipëri.*

27 AMEPJ, V.1982, D.22, fl.12-20, *Material për Kolegjiumin e MPJ, Mbi pritjen e miqve dhe dashamirësve në Shqipëri.*

kushtuar cilësisë së shkrimeve dhe përshtypjeve që jepnin pas kthimit të miqve në vendin e tyre. Në këtë kuadër Komiteti merrte kontakte në rrethe të ndryshme në Shqipërinë e asaj kohe, me përfaqësuesit e Komiteteve Ekzekutive dhe ndërmarrjet që ishin të ngarkuar me pritjen e miqve të huaj, duke zhvilluar me to biseda sesi duhej folur me të huajt, dhe të mos trembeshin nga bindjet e kundërta politike të të ftuarve por të shpjegonin me durim realitetin shqiptar. Për këtë duhej bërë pune paraprake edhe me përkthyesit e shoqëruesit e miqve të huaj.

Në vitet 80-të, kur “armiqtë” rreth Shqipërisë ishin shtuar, dhe vetëizolimi po thellohej, lindi nevoja e shtimit të rradhëve të shoqatave me anëtarë të rinj e cilësore me ndikim në rrethe të caktuara shoqërore. Deri atëhere shumica e antarësisë së shoqatave ishin të rinj e të reja, studentë, punëtorë, pak fshatarë e intelektualë, e një pjesë e madhe e tyre m-l. Pak shoqata përfshinin në radhët e tyre personalitete të shkencës e të kulturës. Kjo përbërje, kishte ngushtuar sferën e veprimtarisë dhe kishte dobësuar karakterin e gjërë që duhet të kishin shoqatat e miqësisë. Mungesa e personaliteteve të tilla nuk jepte mundësi që veprimtaria e shoqatave të bëhej e njohur në auditorët e universiteteve dhe institucioneve shkencore. Në vitin 1985, 43 vende kishin shoqata miqësie me Shqipërinë, ndër to 19 shtete evropiane, 12 në dy Amerikat dhe pjesa tjetër në Azi e Afrikë. Meqenëse shoqatat ishin mjaft të politizuara që nga krijimi i tyre me inisiativën e partive e grupeve m-l, që të mund të përçonin më mirë propagandën komuniste, tani ato ishin kthyer në arenë debatesh ideologjike. Kjo kishte çuar në largimin e shumë miqve nga këto shoqata dhe krijimin e shoqatave paralele që ishin larg fokusit politik të përfaqësive shqiptare. Për të pasur një stabilitet në shoqata Komiteti orientonte që në krye të tyre të vendoseshin personalitete të njohura pa komplekse politike që të shtonin më shumë antarësinë.

Në këtë këndvështrim, Byroja Politike miratoi një platformë të re mbi punën me shoqatat e miqësisë. Kjo platformë përcaktonte qartë se aty mund të merrnin pjesë të gjithë miqtë e dashamirët e Shqipërisë, pavarësisht bindjeve të tyre politike “me përjashtim të trockistëve, anarkosindikalistëve, fashistëve dhe organizatave revizioniste”. Në platformë bëhej thirrje që të rritej pjesëmarrja në shoqata, tu jepej atyre më shumë karakter kulturor e miqësor, duke u larguar nga politizimi i tyre, duke shmangur debatet ideologjike e duke mos u kthyer në seksione partie. Ambasadat shqiptare u udhëzuan që të ndihmonin për të ndikuar në forcimin dhe rritjen e aktivistëve të shoqatave të miqësisë, por pa ndërhyrë në punet e tyre të brendëshme. U la detyrë të bisedohej me partitë m-l mike që të mos ndërhynin shumë në krijimin e drejtimin e shoqatave për shkak të problemeve që kishin filluar të rriteshin brenda shoqatave.²⁸ Ekzistonin

28 AMEPJ,V.1983,D.16, fl.16-26, *Relacion i KMKMBJ*.

edhe shoqata miqsh që nuk drejtoheshin nga partitë m-l. Udhëzimi për to ishte që tu dërgoheshin materiale, të ndiqej ecuria e tyre dhe vetem pasi të njiheshin mire të bëhej njohja e tyre.

Aktiviteti i shoqatave do të thoshte kosto financiare. Zakonisht shteti shqiptar mbulonte vetëm shpenzimet e qëndrimit në Shqipëri dhe jo ato të udhëtimit, por edhe kjo varionte sipas rezultateteve të punës të shoqatës. Nëse kishin prodhuar rezultate të mira, atëherë do ju paguheshin edhe qëndrimi edhe kosto e udhëtimit.

Shoqatat që ndihmoheshin vazhdimisht ishin ato të Francës dhe e Italisë. Ndërsa të tjerat do ndihmoheshin pjesërisht nga përfaqësitë tona vetem kur organizonin veprimtari të rëndësishme.²⁹

Në fund të v.1981, KMKMBJ ankohet në MPJ se shumica e miqve kërkonin tu mbuloheshin shpenzimet e ardhjes në Shqipëri si vizitorë të ftuar, por kjo strukture konkludonte se “ *Në të shumtën e rasteve nuk ia vlen barra qeranë që të paguash aq shumë shpenzime udhëtimi për njerëz që nuk kanë mundësi e as mjete për të bërë ndonjë gjë të madhe për vendin tonë. Ajo çfarë kemi praktikur deri tani është marrja përsipër e shpenzimeve për ndonjë vend të Evropës (Franca e Italia P.D) dhe për elementë të veçantë.*” Për të zgjidhur ngërçin e krijuar, u vendos që shoqatat e miqësisë të mos ndihmoheshin financiarisht me para, por tu dërgoheshin atyre më shumë materiale artizanale shqiptare për ekspozim, të cilat më pas ti shisnin e me to të bënin të ardhura për aktivitetin e tyre. Propozohej gjithashtu të dërgoheshin jashtë grupe të vogla artisitike, artistë e instrumentistë të veçantë që të organizonin ndonjë aktivitet dhe të ardhurat e fituara ti shfrytëzonin shoqatat e krijuara në ato vende.³⁰

E gjithë kjo punë propagandistike mbështetej edhe me dekorimet që bënte shteti shqiptar për anetarë të kolonive shqiptare apo shoqëritë patriotike shqiptare të emigracionit ekonomik, që organizonin aktivitete sa patriotike aq edhe politike në propagandimin e arritjeve të RPSSH. Kandidaturat propozoheshin nga KMKMBJ, miratoheshin nga ish-KQ i PPSH, dhe më pas ekzekutoheshin nga qeveria shqiptare në raste festash kombëtare apo jubileve të çlirimit të vendit.³¹

Në dhjetor të vitit 1987, kur Shqipëria filloi një hapje të kontrolluar me perendimin, Sekretariati i ish-KQ të PPSH vendosi marrjen e masave për rritjen e metejshme të nivelit të propagandës për botën e jashtme,

29 AMEPJ, V.1985, D.70, fl.6, *Relacion i KMKMBJ mbi gjendjen e shoqatave të miqësisë me vendin tone., 8.11.1985.*

30 AMEPJ, V.1983, D.80, fl.1, *Informacion i KMKMBJ për MPJ 8.11.1983, D.16, fl.9, Relacion i KMKMBJ mbi gjendjen e shoqatave të miqësisë me vende të ndryshme dhe detyrat tona.21.3.1983.*

31 AMEPJ, V.1984, D.6, fl.1,31. *Korrespondencë mbi dekorimin e shoqërive patriotike jashtë vendit, nëntor 1984.*

bërja e një propagande të diferencuar për zona, vende, gjuhë e kategori të ndryshme të publikut të niveleve dhe shtresave të ndryshme shoqërore, botimet për jashtë të mos ishin vetëm përkthime të botimeve të bëra për publikun vendas por të bëheshin enkas për t'ju dërguar publikut të huaj, të propagandohej jo me ideologji, por me vlera, duke dërguar jashtë lektorë të kualifikuar, personalitete të jetës ekonomike e shoqërore, zotërues të gjuhëve të huaja e të aftë që të përballonin debatet e mundëshme në këto raste. Për të njëjtën arsye u vendos gjithashtu krijimi i shoqatave të miqësisë të popullit shqiptar me popujt e vendeve të tjera pranë KMKMBJ, duke aktivizuar në to një numër personalitetesh të kulturës dhe jetës shoqërore të asaj kohe në Shqipëri. Ato do të funksiononin si Komisione Miqësie me vendet e tjera pranë KMKMBJ. Kjo ide kishte kohë që përmendej, madje edhe në dokumente të shkruara, por nuk kishte gjetur kushte për tu zbatuar në një Shqipëri të mbyllur. Po kështu u vendos të punohej me brezin e ri të emigracionit ekonomik, që ishin të martuar me të huaj, për të zgjeruar rrjetin e propagandës në ambjente të tjera, tu mësohej shqip ketij brezi emigrantësh dhe të lejohej ardhja e tyre familjarisht në Shqipëri. Vendosija e atasheve kulturore dhe atasheve të shtypit efektivë nëpër përfaqësitë shqiptare, sidomos në disa me specifike si ato në Francë, Austri, RFGj, Suedi, Greqi, Itali, Jugosllavi e Neë York, shihej si një nevojë e domosdoshme për një punë më të kualifikuar të përfaqësive shqiptare me shoqatat e kolonitë shqiptare jashtë vendit.³²

Në fillim në Tiranë u krijuan shoqata miqësie në bazë kontinenti; Evropa, Azi, Afrike, Amerike e Vendet Arabe. Kryesia e këtyre shoqatave u miratua nga Sekretariati i ish-KQ të PPSH. Pranë KMKMBJ u caktua një person i veçantë që do të merrej me punën që kishte të bënte me shoqatat e miqësisë së popullit shqiptar me popujt e kontinenteve të tjera.³³ Anëtarët e këtyre shoqatave ishin personalitete me emër në fushat e tyre, drejtues të institucioneve shkencore në vend dhe artistë të popullit.

Sipas rregullores së këtyre shoqatave ato do të ndihmonin për një punë më të kualifikuar me miqtë dhe personalitetet e ndryshme që vizitonin Shqipërinë. Ato nuk lejoheshin të kishin lidhje të drejtëpërdrejta me institucione jashtë, por nëpërmjet KMKMBJ dhe në raste të veçanta me shoqatat e miqësisë me Shqipërinë që funksiononin jashtë, për të ftuar delegacione nga ato, personalitete kulturore, shoqërore ose politike.³⁴

Pas ngjarjeve të korrikut 1990, hyrjes së shqiptarëve në selitë e përfaqësive të huaja të akredituara në Tiranë, Presidiumi i Kuvendit

32 AMEPJ, Fondi i KMKMBJ, V.1987/ *Udhëheqja.Raport "Gjendja dhe masat për rritjen e nivelit të propagandës me botën e jashtme", 10.12.1987.*

33 AMEPJ, V.1988, D.2, fl.20-21. *Korrespondencë e MPJ me KQ të PPSH mbi krijimin e shoqatave të miqësisë të popullit shqiptar me të tjeret, 9.11.1988.*

34 Po aty, fl.26-27.

Popullor të RPS të Shqipërisë miratoi Dekretin 7442, 17.12.1990, “Për të drejtën e marrjes së iniciativës nga individë të veçantë për krijimin e shoqatave të miqësisë me vende të caktuara”. Keto shoqata do te ishin të pavarura, por do të merrnin miratim per krijimin e tyre nga MPJ, konkretisht KMKMBJ. Per këtë procedure grupi nismëtar do të duhej të paraqiste një kërkesë të nënshkruar nga të gjithë nismëtarët dhe Statutin e Shoqatës. MPJ i miratonte me një Urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe dokumentacioni i tyre themelues i kalonte Arkivit të MPJ. Shoqatat e krijuara rregjistroheshin në MPJ.³⁵

Pas zgjedhjeve pluraliste të 31 marsit 1991, dhe krijimit të qeverisë së re, politika dhe aktiviteti kulturor me jashtë do të merrte dimensione të reja. Këto ndryshime do ti pasqyronte edhe struktura e MPJ. Në shtator 1991, Ministri i Punëve të Jashtme të asaj kohe, Muhamet Kapllani, i drejtohet Këshillit të Ministrave me propozimin që KMKMBJ të kthehej në Drejtori të Bashkëpunimit Kulturor, Teknik dhe Shkencor. Për këtë kërkonte shfuqizimin e VKM nr.181, dt.10.6.1977 “Mbi miratimin e rregullores së Komitetit Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme”.

Kjo u realizua me VKM nr.387, dt.24.10.1991, nëpërmjet të cilit KMKMBJ u kthye në Drejtori të Bashkëpunimit Kulturor, Teknik e Shkencor pranë MPJ, pa i ndryshuar strukturën. Drejtor i saj u emërua Rudolf Marku, personalitet në fushën e letrave shqipe, nga rradhët e opozitës, e zv.Drejtor Jorgo Milica ish-Drejtor i KMKMBJ, i cili më vonë u largua me kërkesën e opozitës me argumentin që “*ndryshimet vizionare e cilësore të marrëdhënieve kulturore me jashtë nuk mund të bëheshin pa lëvizje, ndryshime dhe zëvendësime të kuadrit.*” U suprimua si i tepërt Sektori i Propagandës i cili përgatiste materiale propagandistike për jashtë . Në kushtet e depolitizimit dhe çideologjizimit të shtetit, respektivisht të MPJ, ky sektor suprimohej. Ai u zëvendësua me Sektorin e Promovimit të Vlerave Kulturore Kombëtare për jashtë. U shkurtua Sektori i Shoqatave. Drejtoria do të quhej Drejtoria e Marrëdhënieve Kulturore me tre sektorë : Marrëdhënie e Veprimtari Bilaterale, Marrëdhënie dhe Veprimtari me Organizatat Ndërkombëtare, Sektori i Promocionit te Vlerave Kulturore Kombëtare në botë.³⁶ Po në tetor të v.1991, me Urdhërin nr.98, dt.29.10.1991 të Ministrit te Punëve të Jashtme, u mbyll edhe revista “Shqipëria e re”, me argumentin që ishte krijuar vite më parë për arsye propagandistike të asaj kohe, dhe se nuk justifikonte shpenzimet për mbajtjen e saj.³⁷

35 AMEPJ, V.1991, *Fondi i KMKMBJ, Praktika e krijimit të Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Spanjë*, 12.3.1991.

36 AMEPJ, V.1991, D.1233, fl.1-9, *Krijimi i Drejtorisë së Marrëdhënieve Kulturore*.

37 AMEPJ, V.1991, D.1235, fl.1-2, *Urdhëri i MPJ për mbylljen e revistes “Shqipëria e Re”, 29.10.1991.*

Kështu përfundoi edhe rrugëtimi i Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme. Propaganda shtetërore në mbështetje të rregjimit politik dhe ideologjisë së partisë në pushtet, i la vendin diplomacisë publike për promovimin e vlerave kombëtare historike e kulturore të popullit shqiptar.